



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 11809 Prot.

Fier, më 20.10.2025

Lënda: Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak

Drejtuar: ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK FIER

Për dëgjim: KRYETARIT TË BASHKISË FIER
PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, nenit 56 pika 2, shkronja "a", të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, ju njoftojmë thirrjen e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Fier në sallën e këshillit ditën e **Enjte datë 30.10.2025 në orën 13:30** me këtë rend dite:

1. Miratimi i Rendit të Ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë **25.09.2025**
3. **Projekt-vendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %, për muajin shtator 2025."
Komisioni përgjegjës: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Infrastrukturës dhe Strehimit.
4. **Projekt-vendim:** "Për miratimin e shpenzimeve të varrimit të shtetases Zoicë Dylgjeri."
Komisioni përgjegjës: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Infrastrukturës dhe Strehimit.
5. **Projekt – vendim:** "Për miratimin e rishikimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Fier dhe Shoqërisë Rajonale 'Ujësjellës-Kanalizime Fier' sh.a."
Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.
6. Diskutime dhe komente.

Kryetar Këshilli
Antoneta Cunaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK FIER
KRYESIA

Nr. 11808

Fier në 20.10.2025

VENDIM NR. 28 DATË 20.10.2025

PËR MIRATIMIN E RENDIT PARAPRAK TË DITËS PËR MBLEDHJEN E DATËS

Kryesia e Këshillit Bashkiak Fier në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 27 datë 15.04.2020 "Për miratimin e rregullores së Këshillit Bashkiak, rregullores për Konsultimet Publike dhe Kodin e Sjelles për funksionimin e Këshillit", Kreu 2, neni 22 "Kryesia e Këshillit" neni 1, 3, 4

VENDOSI:

1-Miratimin e Rendit paraprak të Ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të zhvillohet në datën 30/10/2025 ora 13:20. Bashkëlidhur këtij vendimi gjenden pikat e Rendit paraprak të Ditës.

2-Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak për publikimin e njoftimit të Rendit të Ditës, si dhe njoftimin e Këshilltarëve, Kryetarit të Bashkisë dhe çdo personi tjetër të interesuar për pjesëmarrje në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

3-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYESIA E KËSHILLIT

1-Antoneta Çunaj

2-Arben Cuko

3-Fatbardha Merkaj

4-Evis Sema

5-Kreshnik Dapi

6-Endri Jaupaj

7-Rrapi Gjika